


Koncepti i adhurimit në Islam



| Program mësimor |

Dr. Akil bin Salim esh-Shemri

Dr. Akil bin Salim esh-Shemri

**Koncepti i adhurimit
në Islam**

Program mësimor

Përktheu nga origjinali.

Kastriot Bardhi



Titulli origjinal i librit:

فقه العبودية

(Fik'hu el ubudijeti)

Koncepti i adhurimit në Islam

Autor: **Dr. Akil bin Salim esh-Shemri**

Përktheu: **Kastriot Bardhi**

Redaktoi: **Valmira Bardhi**

Dizenjoi: **Julian Kapo**

Korçë,

Prill 2022

(Ramazan 1443)



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

PËRMBAJTJA

Hyrje: Pasi të hiqni “rrobat” tuaja, vishni “robën” e adhuruesit të Allahut.....	6
Kapitulli i parë:	
Bazat dhe thelbi adhurimit.....	12
Mësimi i parë: Adhurimi është përkushtim absolut ndaj Allahut dhe zbatim i përpiktë i fesë së Tij.....	13
Mësimi i dytë: Të qenit rob adhurues i Allahut është tipar i lavdërueshëm..	19
Mësimi i tretë: Harmonia ndërmjet attributeve të njeriut dhe robërimit të tij ndaj Allahut.....	26
Mësimi i katërt: Sprovat të kthejnë në adhurimin e sinqertë.....	32
Mësimi i pestë: Baza dhe thelbi i adhurimit.....	38
Mësimi i gjashtë: Allahu nuk adhurohet veçse me sheriatin e Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).....	44
Mësimi i shtatë: Nënshtrimi është cilësia më e veçantë e robit.....	53
Mësimi i tetë: Nënshtrimi i përhershëm ndaj Allahut.....	57
Mësimi i nëntë: Nënshtrimi ndaj Allahut është në lidhje të ndërsjellë me njohjen e cilësive të Tij.....	61
Kapitulli i dytë:	
Rebelimi kundër adhurimit të Allahut.....	67
Mësimi i parë: Çfarë ka mbetur nga gjynahet tona?.....	68
Mësimi i dytë: Rebelimi kundër adhurimit të Allahut.....	73
Mësimi i tretë: Konceptimi i drejtë i shkaqeve të ligjëruara nga sheriati.....	79
Mësimi i katërt: Për hir të Allahut dhe me ndihmën e Allahut.....	85
Mësimi i pestë: Kur dashuria shndërrohet në torturë.....	91
Mësimi i gjashtë: Si të rritet dhe forcohet dashuria për Allahun?.....	97
Mësimi i shtatë: Disa rregulla për të kuptuar adhurimi.....	101
Mësimi i tetë: Koncepti i adhurimit në ajetin Kursij.....	104
Mbyllje: Shembulli i robit dhe zotëriut të tij.....	110

Hyrje

Pasi të hiqni “rrobat” tuaja, vishni “rrobën” e adhuresit të Allahut

**Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut!
Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin
për të Dërguarin e Tij!**

Nëse je student, hiqe “rrobën” e studentit dhe vish “rrobën” e adhuresit! Nënpunësi duhet të veshë “rrobën” e adhuresit. Mjeku në klinikën e tij është adhures; bujku është adhures. Secili ka për detyrë ta konsiderojë punën e tij jo thjesht profesionin, por mision, nëpërmjet të cilit e adhuron Allahun dhe përpiqet të fitojë kënaqësinë e Tij, sikurse e realizon këtë nëpërmjet namazit.

Në këtë kontekst, Ebu Dardai thotë: “Për sa kohë që je duke përmendur Allahun, shpirtërisht je

në namaz, ndonëse fizikisht mund të ndodhesh në pazar.”

Duke pasur një koncept të drejtë për adhurimin, ti ke mundësi që e gjithë jeta jote të shndërrohet në adhurim. Kështu, e adhuron Allahun në një mënyrë të veçantë me ruku, sexhde dhe tesbih, sikur je gjithmonë në namaz, në lidhje të drejtpërdrejtë me Zotin tënd të Lartësuar, siç thotë Muadh bin Xhebeli (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!): “Mësojeni diturinë, sepse të nxënit e saj për hir të Allahut është frikërespekt, kërkimi i saj është adhurim, studimi i saj është madhërim (ndaj Allahut).” Kështu pra, kërkimin e dijes e konsideroi adhurim. Çdo vepër që bën për hir të Allahut është një formë e veçantë adhurimi dhe madhërimi ndaj Tij. Kur gëzon mirësitë e Allahut, fillon të hash apo të pish, duke kërkuar ndihmën e Allahut dhe bekimin e Tij nëpërmjet përmendjes së emrit të Tij, në këtë mënyrë e ke madhëruar dhe lavdëruar Atë. Gjithashtu, Allahun e Lartësuar e madhëron me zemër përmes besimit e bindjes së palëkundur se të gjitha mirësitë që gëzon janë prej Tij. Pastaj, pasi shijon ushqimin dhe pijen, e shpreh mirënjohjen ndaj Dhuruesit të Begatë duke e falënderuar dhe lavdëruar Atë.

Kur je duke kërkuar riskun prej Allahut, zemra jote e adhuron Atë në një mënyrë të veçantë. Përkujdesi ndaj familjes është një formë tjetër adhurimi. Ruajtja e forcimi i lidhjeve farefisnore, respektimi i prindërve dhe bamirësia ndaj tyre janë shprehje të adhurimit, që pasqyrohet me anë të sjelljes së mirë, shërbimit me përkushtim ndaj tyre, sakrifikimit për ta etj.

Trupi dhe zemra e adhurojnë Allahun, secili në mënyrën e vet: trupi nëpërmjet sexhdes, duke e vendosur ballin në tokë e duke u ngritur prej saj në mënyrë të herëpashershme, teksa “sexhdja” e zemrës është e përhershme.¹ “Sexhdja” e zemrës është mishërim i përlësisë dhe nënshtrimit të përhershëm ndaj Allahut, kthimit të vazhdueshëm tek Ai dhe gjetjes së prehjes shpirtërore duke përmendur emrin e Tij.

Të konceptuarit e drejtë të “*ubudijetes*”² e bën besimtarin të shijojë adhurime të njëpasnjëshme,

¹ Medarixhu salikin (1/428).

² Në arabisht, kuptimi leksikor i fjalës “*ubudije*” është robëri. Ndërsa në terminologjinë fetare, ajo vjen në

jo vetëm në xhami, por edhe në shtëpi, në punë, në familje e kudo. Ky është një ndër kuptimet e ajetit kuranor, në të cilin Allahu i Lartësuar thotë:

(فَإِذَا فَرَغْتَ فَانصَبْ)

“Pasi të kesh përfunduar *(preokupimet)*, atëhere, për hir të Zotit tënd, përpigu fort *(me adhurime)!*” (El Inshirah: 8) Në komentin e këtij ajet, komentuesit e Kuranit thonë se pasi të kesh përfunduar një adhurim, mundohu ta pasosh me një tjetër, sepse rehatia e besimtarit është në Xhenet.

Në këtë kontekst, natyrshëm parashtrohen pyetjet e mëposhtme:

kuptimin e bindjes, nënshtrimit dhe dorëzimit absolut ndaj Allahut, duke e adhuruar Atë me devocion dhe përkushtim. (*Mu'xhemu lugatu el fukahai* - Fjalori i gjuhës së juristëve)

Në fakt, titulli origjinal i këtij libri është: *"فقه العبودية"* - *"Fik'hu el ububijeti"*, që i përkthyer fjalë për fjalë do të thotë: "Konceptimi i të qenit rob i Allahut". Nisur nga përkufizimi (fetar) i mësipërm, e pashë të arsyeshme që titullin e librit *"Fik'hu el ububijeti"* ta shqipëroj: **"Koncepti i adhurimit në Islam"**. Allahu e di më së miri. (shën. përkth.)

- Cila ishte ajo gjë e veçantë në zemrën e Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), që e bëri atë më të mirin e shokëve të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)?
- Përse rukuja, sexhdja, tesbihi dhe lëmosha e Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ishin më të mira se e adhuresëve të tjerë, ndonëse sasia e adhurimeve të tyre ishte më e madhe?
- Si mund të ngjyrosët gjithë jeta e besimtarit me adhurim?
- Si ta adhurojë besimtari Allahun jashtë xhamisë, sikurse e adhuron në xhami?
- Si mund jesh një adhures i përkushtuar gjatë gjithë jetës tënde?
- Si mund t'i japësh jetës tënde ngjyrimin e adhurimit, për të cilin Allahu i Lartësuar thotë:
(صِبْغَةَ اللَّهِ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ صِبْغَةً وَعَنْ لَهُ عَابِدُونَ)
“Thoni: “Kjo fe është “ngjyra” që na ka dhënë Allahu! S’ka “ngjyrë” më të bukur se ajo që jep Allahu! Ne vetëm Atë adhurojmë!”?
 (El Bekare: 138)
- Si mund të keni një zemër të përlurur e nënshtruar ndaj Allahut?

- Çfarë do të thotë rebelim kundër adhurimit të Allahut dhe cilat janë format e shfaqjes së tij në realitetin bashkëkohor?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe shumë të tjerave si këto, i gjeni në këtë libër të titulluar **“Koncepti i adhurimit në Islam”**.

Falënderoj Allahun e Gjithëfuqishëm, i Cili ma lehtësoi trajtimin e kësaj teme në formatin e një programi mësimor, që është i përshtatshëm për kurset e mësimit të fesë, qendrat islame etj. Leja i jepet kujtdo që dëshiron ta përkthejë atë. Falënderoj Fondacionin “Frytet e bamirësisë” për shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e këtij libri.

Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin!

Autori

Kapitulli i parë:

**Bazat dhe thelbi
i adhurimit**





Mësimi i parë:



Adhurimi

është përkushtim absolut ndaj Allahut
dhe zbatim i përpiktë i fesë së Tij

Allahu i Lartësuar në Kuran thotë:

(فَإِنْ آمَنُوا بِمِثْلِ مَا آمَنْتُمْ بِهِ فَقَدِ اهْتَدَوْا وَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا هُمْ فِي شِقَاقٍ فَسَيَكْفِيكَهُمُ اللَّهُ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ صِبْغَةَ اللَّهِ وَمَنْ أَحْسَنُ مِنَ اللَّهِ صِبْغَةً وَنَحْنُ لَهُ عَابِدُونَ)

“Nëse ata besojnë në atë që besoni edhe ju, atëherë janë në rrugën e drejtë. E, nëse ia kthejnë shpinën asaj, atëherë sigurisht që do të përçahen. Por Allahu të mjafton ty *(Muhamed si mbrojtës)* kundër atyre. Ai është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri. Thoni: “Kjo fe është “ngjyra” që na ka dhënë Allahu *(sibgati i Allahut)*! S’ka “ngjyrë” *(sibgah)* më të bukur se ajo që jep Allahu! Ne vetëm Atë adhurojmë!” (El Bekare: 137-138)

Leximi me meditim i këtyre dy ajeteve, na

mundëson të parashtrojmë disa pyetje të mirëmenduar:

Cili është kuptimi i fjalës “*sibgah*”?

Cila është arsyeja që fesë i bëhet një përshkrim i tillë?

Çfarë do të thotë ky përshkrim?

Cilat janë efektet e tij?

Kuptimi i fjalës “*Sibgah*”

Sibgah është ngjyrosja e gjërave, si p.sh. ngjyrosja e rrobave etj., me ngjyra të caktuara.

Përmes përdorimit të kësaj fjale në ajet synohet dhënia e mesazhit: Qëndrojeni besnikë fesë së Allahut, besimit të natyrshëm në të cilin Ai ju krijoi qysh në gjenezë (krijimi fillestar), në formë dhe në përmbajtje.

Arsyeja përse fesë i bëhet një përshkrim i tillë

Ashtu si ngjyra është element i pandashëm i veshjes, lëkurës etj., ashtu edhe feja “ngjyros” zemrën e robit dhe gjymtyrët e tij; është pjesë e qenësishme e tij, e shoqëron atë në çdo gjendje, nuk ndahet kurrë prej tij.

Çfarë do të thotë përshkrimi i fesë me *sibg-ën* (ngjyrën)?

Përshkrimi i fesë me *sibg-ën* (ngjyrën) do të thotë që besimi duhet të “ngjyrosë” brendësinë dhe pamjen e jashtme të njeriut. Zemra e tij është “e ngjyrosur” me besimin në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në Ditën e Fundit dhe në kaderin e Tij, ndërsa në aparence ai merr “ngjyrën” e sheriatit islam, duke iu nënshtruar urdhrave dhe dispozitave të Allahut me kënaqësi e vullnet të lirë, i motivuar nga dashuria për Të. Kështu pra, harmonizohet dhe

përputhet përmbajtja dhe forma e robit të Allahut, e adhuruesit të singertë të Tij.

Defektet që vijnë si pasojë e keqkuptimit të *sibg-ës* (fesë dhe besimit)

Duke mos pasur një koncept të qartë për fenë dhe domosdoshmërinë e mishërimit të saj në formë dhe përmbajtje, një pjesë e njerëzve i kushtojnë rëndësi formës (aparencës) në hesap të përmbajtjes (brendësisë). Ja disa mënyra të shfaqjes së këtij fenomeni:

1. Përqëndrimi i vëmendjes vetëm te veprimet e gjymtyrëve, duke e shoqëruar me shkujdesje totale ndaj punëve të zemrës, si në rastin kur tregohet kujdes i madh ndaj veprimeve të namazit, teksa nënvlerësohet singëriteti dhe frikërespekti ndaj Allahut gjatë faljes së tij (namazit).

2. Përpyekja maksimale për kryerjen e veprimeve përmes gjymtyrëve, qofshin ato edhe vepra të pëlqyera apo vullnetare, teksa nënvlerësohen punët e zemrës, që janë detyrë, si p.sh.: dashuria, droja, shpresa, mbështetja e singertë tek Allahu etj.

3. Vetëkritika e cinguar, duke marrë veten në llogari për veprat që kryejnë gjymtyrët dhe jo për adhurimet e zemrës, si në rastin kur qorton veten për rrëshqitjet e gjuhës, ndërkaq, nënvlerëson sëmundjet e zemrës, si: zilinë, lakminë, mllëfin, urrejtjen, mendjemadhësinë, hipokrizinë etj.

Ushtrim

Plotëso vendin bosh:

Allahu i Lartësuar thotë: “Kjo fe është “ngjyra” që na ka dhënë Allahu (*sibgati i Allahut*)!” Përshkrimi i fesë me *sibg-ën* (ngjyrën) do të thotë që:

-.....

-.....

Mësimi i dytë:

Të qenit rob adhures i Allahut është tipar i lavdërueshëm

Kur Allahu dëshiron të lavdërojë ndonjë prej krijesave të Tij, e cilëson atë **rob adhures**, sikurse ka thënë për Sulejmanin dhe Ejubin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dy!):

(نِعْمَ الْعَبْدُ)

“Një rob të mrekullueshëm.” (Sad: 30)
Gjithashtu ka thënë edhe për disa profetë (për secilin prej tyre) të tjerë:

(إِنَّهُ مِنْ عِبَادِنَا)

“Vërtet, ai ishte nga robërit Tanë besimtarë.”
(Es-Safat: 81) Ndërsa për të Dërguarin e Tij, Muhamedin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ka thënë:

(سُبْحَانَ الَّذِي أَسْرَىٰ بِعَبْدِهِ)

“I Dëlirë qoftë Ai, që e mbarti robin e Tij
(Muhamedin) natën.” (El Isra: 1)

Të qenit rob adhures i Allahut nuk është tipar vetëm i dy më të rëndësishmëve (njerëzve dhe xhindëve)

Allahu i krijoi gjithë krijesat që t'i dorëzohen dhe t'i nënshtrohen Atij, ta madhërojnë duke e lavdëruar dhe ta duan Atë, të kthehen tek Ai të penduar dhe ta ndiejnë se janë nevojtarë për Të. Allahu dëshiron që roberit e Tij ta lavdërojnë e ta madhërojnë, t'i luten e t'i kërkojnë, t'i përulen e t'i binden Atij, sikurse thotë i Lartësuari:

(وَلَهُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ كُلُّ لَّهُ قَائِمُونَ)

“Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Gjithçka i përulet Atij.” (Er-Rum: 26)

Për shpendët thotë:

(وَالطَّيْرُ صَافَّاتٍ كُلُّ قَدْ عَلِمَ صَلَاتَهُ وَتَسْبِيحَهُ)

“...edhe shpendët krahëhapur? Secila (*qenie*) e di mënyrën se si t'i lutet e si ta lavdërojë Atë.” (En-Nur: 41)

Për përuljen e krijesave thotë:

(وَلِلَّهِ يَسْجُدُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ)

“Allahut i përulet në sexhde gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë.” (Er-Ra’d: 15)

Adhuresi i Allahut është në përputhje të plotë me universin që e rrethon

Çdo gjë në univers e adhuron Allahun, e lavdëron dhe e shenjtëron, e madhëron dhe e lartëson Atë, siç thotë i Lartësuari:

(وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ)

“Nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju *(o njerëz)* nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata.” (El Isra: 44)

Gjithashtu thotë:

(سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ)

“Allahun e lartëson me adhurim gjithçka që është në qiej dhe në Tokë.” (El Hadid: 1)

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë për gjallesat: “*Në ditën e*

xhuma, çdo gjë e gjallë tmerrohet nga frika se mos bëhet Kijameti.”³ Ndërsa për milingonat ka thënë:

*“Janë krijesa që e madhërojnë Allahun.”*⁴

Çdo krijesë në gjithësi e adhuron Allahun dhe i nënshtrohet Atij. Kështu pra, adhuruesi i Allahut është në përputhje të plotë me universin që e rrethon. Kushdo që i kthen shpinën adhurimit, konsiderohet anormal në këtë univers të nështruar ndaj Allahut.

Si e adhurojnë Allahun krijesat?

Krijesat i nënshtrohen Allahut në mënyrë krejt të natyrshme, sepse ato e shohin veten nën pushtetin e Zotit, nën varësinë e Tij, në dorën e Tij. Ato mbështeten tek Ai për të siguruar jetesën. Nuk i atribuojnë vetes mundësinë dhe fuqinë, sepse ato posedojnë mundësi dhe fuqi aq sa u jep

³ Ibn Huzejme në *“Sahihun”* e tij (114/3).

⁴ Buhariu nr. 3019.

Zoti i Gjithëfuqishëm. Prandaj, janë lidhur me Allahun, Krijuesin dhe Furnizuesin e tyre, për të realizuar atë që dëshiron i Adhuruari i tyre. Për këtë arsye, i nënshtrohen Atij, e duan, e lavdërojnë, e shenjtërojnë, e madhërojnë Emrin e Tij; çdo çështje ia lënë në dorë Atij, duke u mbështetur tek Ai për çdo gjë, sikurse e ka përshkruar Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) shpendin që mbështetet tek Zoti i Plotfuqishëm: *“Sikur ju të mbështeteni te Allahu ashtu siç duhet, Ai do t’ju siguronte mjetet e jetesës, ashtu siç e furnizon shpendin.”*⁵

Të gjitha legjislacionet hyjnore sanksionojnë detyrën e adhurimit të Allahut

Legjislacionet hyjnore, ndonëse kanë dallime ndërmjet tyre, të gjitha sanksionojnë detyrën e adhurimit të Allahut, siç thotë Allahu i Lartësuar:

(وَلَقَدْ بَعَثْنَا فِي كُلِّ أُمَّةٍ رَسُولًا أَنِ اعْبُدُوا اللَّهَ وَاجْتَنِبُوا الطَّاغُوتَ)

⁵Tirmidhiu në “Sunenin” e tij nr. 2344. Shejh Albani pohon se ky hadith është autentik.

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni vetëm Allahun...”

(En-Nahl: 36)

Këto legjislacione janë shprehje e nënshtimit ndaj Allahut, nëpërmjet ligjit dhe programit të caktuar që Ligjvënësi sanksion për çdo popull, siç thotë i Lartësuari:

(إِكُلَّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا)

“Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë.” (El Maide: 48) Për çdo popull, Allahu përcaktoi rrugë dhe ligje, nëpërmjet të cilave i nënshtrohen dhe i përulen Atij, sepse Ai është Sunduesi që ligjëron çfarë dëshiron, si dëshiron dhe për kë dëshiron. Kështu që, nuk mund të mësojmë se çfarë dëshiron Allahu prej nesh apo si ta adhurojmë Atë, apo si t’i përulemi dhe nënshtrohemi Atij, vetëm se nëpërmjet të dërguarve të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!)

Ushtrime

1. Të gjitha krijesat e adhurojnë Allahun.
Trego mënyrën se si e adhurojnë Allahun krijesat e mëposhtme:

a. Milingona.....

.....

.....

b. Malet.....

.....

.....

2. A kanë të gjitha fetë të njëjtin legjislacion?

.....

.....

.....

Mësimi i tretë:

Harmonia ndërmjet attributeve të njeriut dhe robërimit⁶ të tij ndaj Allahut

Kush mediton për cilësitë e njeriut, gjen se ka një lidhje të qenësishme e të domosdoshme ndërmjet këtyre cilësive dhe shkakut të krijimit të tij, që është: adhurimi i Allahut të Lartësuar.⁷ Allahu e krijoi njeriun në formën më të mirë të mundshme, për t'iu përshtatur më së miri pozitës së tij si **rob adhurues**. Disa nga këto cilësi janë:

⁶ Të qenurit rob i përkushtuar ndaj Allahut dhe plotësisht i lirë prej gjithkujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar. (shën. përkth.)

⁷ Pra, njeriu është pajisur me këto attribute që të realizojë lehtësisht qëllimin për të cilin Allahu e krijoi, që është: adhurimi i të Lartësuarit pa i shoqëruar Atij asnjë ortak; atributet e përmendura në mësim janë pikërisht në funksion të këtij qëllimi. (shën. përkth.)

1. Njeriu është krijesë

Krijimi i njeriut dëshmon se ai është nevojtar dhe i varfër. Varfëria është atribut thelbësor, i qenësishëm dhe i pandashëm prej tij. Kështu që, për të plotësuar nevojat e tij, ai duhet patjetër t'i drejtohet, t'i nënshtrohet e t'i dorëzohet plotësisht një të Pasuri Absolut, i Cili është i Vetëmjaftueshëm, i Gjithëfuqishëm, që nuk ka nevojë për krijesat, ndërsa gjithë krijesat kanë nevojë për Atë, siç thotë Allahu i Lartësuar:

(يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ)

“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun, kurse Allahu s’ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd.” (Fatir: 15)

2. Origjina e krijimit të njeriut është dheu

Në këtë kontekst, Allahu i Lartësuar thotë:

(وَاللَّهُ خَلَقَكُمْ مِنْ تُرَابٍ)

“Allahu ju krijoi prej dheut (*Ademin*)...” (Fatir: 11)

Ai që origjinën e vet e ka prej dheut dhe do të kthehet sërish në dhe’, a nuk është më mirë për të

që t'i nënshtrohet dhe t'i dorëzohet Krijuesit të tij?

3. Është krijuar nga një lëng i dobët

Allahu e krijoi njeriun nga një lëng i dobët, sikurse thotë i Lartësuari:

(الَّذِينَ نَخَلَقُكُمْ مِنْ مَّاءٍ مَّهِينٍ)

“A nuk ju krijojmë nga një lëng i dobët...?!”
(El Murselat: 20)

Kështu pra, njeriu është krijuar nga një lëng i pështirë e i përçmuar. Kjo e përgatit shpirtin njerëzor për të pranuar realitetin e të qenit rob i Allahut, Krijuesit të Tij.

4. Ai është i vogël në madhësi dhe në formë

Krahasuar me krijesat e tjera, njeriu është i vogël në madhësi dhe në formë, siç thotë Allahu i Lartësuar:

(الْخَلْقِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ أَكْبَرُ مِنْ خَلْقِ النَّاسِ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ)

“S’ka dyshim se krijimi i qiejve dhe i Tokës është çështje më e madhe se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Gafir: 57)

Nëse njeriu do të kishte madhësinë e maleve, ai mund të pretendonte se mbështetet në fuqitë e veta. Allahu e krijoi atë (njeriun) në një formë që e i përshtatet *ubudijes* - të qenit rob i Tij.

5. Dobësitë e tij

Ka shumë aspekte të dobësisë njerëzore. Njeriu nuk fluturon dhe ka aftësi të kufizuara në dëgjim e shikim. Gjithashtu, edhe dija e tij është e kufizuar. Agrument i mjaftueshëm i injorancës së njeriut është fakti se ajo që ai di është e kufizuar, ndërsa ajo që nuk di është e pakufizuar. Ai ka nevojë të hajë e të pijë, të nxjerrë jashtë mbeturinat e ushqimeve dhe lëngjeve, të çlodhet e të flejë gjumë. Ai vuan nga dhimbjet, mërzia, frika e vetmia, sikurse mundohet nga acari dhe nxehtësia. Është i dobët përballë epsheve dhe pasioneve të shpirtit; shpesh jeton me iluzione... dhe shumë aspekte të tjera të dobësisë së tij.

Kushdo që mediton për këto attribute, e njeh veten

Ndjenja e nevojës për Allahun dhe shtysa e vetvetishme për t'iu nënshtruar e për t'iu mbështetur Atij, janë prirje dhe aftësi të lindura, që përputhen me atributet e njeriut dhe natyrën e krijimit të tij, siç thotë Allahu i Lartësuar:

(وَإِذَا مَسَّ الْإِنْسَانَ الضُّرُّ دَعَانَا لِجَنْبِهِ أَوْ قَاعِدًا أَوْ قَائِمًا)

“E kur njeriut i bie një e keqe, ai na lutet, qoftë shtrirë, ulur ose në këmbë.” (Junus: 12)

Ushtrime

Qarkoni përgjigjen e saktë.

Prej attributeve të njeriut që i përshtaten më së miri pozitës së tij si rob adhures është:

1. fakti që ai është krijesë,
2. është i vogël në madhësi,
3. e mban veten më lart se të tjerët (është kryelartë),
4. ka uri, etje e nevoja të ndryshme,
5. është krijuar nga një lëng i dobët,
6. është i fortë dhe tiran.

Mësimi i katërt:

Sprovat

të kthejnë në adhurimin e singertë

Allahu e nderoi njeriun, duke e lartësuar atë në pozitën e adhuruesit. Ai është i lidhur me Zotin, i lutet Atij dhe përgjërohet për Atë, i kërkon ndihmë dhe udhëzim. Ndërsa Zoti ia pranon lutjet, e ruan, e ndihmon, e udhëzon dhe i dhuron shumë të mira e begati. Nga ana tjetër, djajtë bëjnë të gjitha përpjekjet për ta shmangur robin nga adhurimi i Allahut, siç na citon Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) fjalët e Allahut në një hadith kudsij (të shenjtë):

“Unë i krijova të gjithë robërit e Mi në besimin e pastër islam⁸. Pastaj atyre u erdhën djajtë dhe i devijuan nga feja e vërtetë.”⁹

⁸ Që të adhurojnë vetëm Allahun me dashuri dhe madhërim, sepse vetëm Ai është i Denjë për adhurim, askush nuk meriton të adhurohet përveç Tij. (shën. përkth.)

⁹ Muslimi nr. 2865.

Kur robi ka mangësi në adhurim, atëhere Allahu e mëshiron nëpërmjet sprovave, për ta kthyer në vendin që i takon, sepse pozita e adhuruesit është shkalla më e lartë e nderimit të tij. Përmes sprovimit me fatkeqësi, Allahu nxjerr në pah cilësitë që Ai i dëshiron prej robit të Tij: të ndjejë e të shfaqe nevojën për Zotin e tij, t'i përulet e t'i nënshtrohet Atij. Ndërsa duke e sprovuar me mirësi e begati, Allahu nxjerr në dritë të tjera cilësi, që Ai dëshiron nga robi i Tij në momente gëzimi dhe hareje: falënderimi dhe mirënjohja, përmbushja e detyrimeve që ka ndaj Zotit dhe krijesave të Tij, si dhe përdorimi begative e të mirave që i ka dhënë Allahu në bindjen ndaj Tij. Kështu pra, Allahu e krijoi vdekjen dhe jetën për t'i vënë në provë robërit e Tij, se cili prej tyre do të bëjë punët më të mira dhe do të dalë me rezultate më të shkëlqyera në garën e adhurimit të Allahut, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

(الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا ۗ وَهُوَ الْعَزِيزُ
الْغَفُورُ)

“Është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë.”
(El Mulk: 2)

Cilësitë e zemrave

Duke qenë se zemra është epiqendra e adhurimit, robi duhet të njohë cilësitë dhe gjendjet e saj. Këto çështje Allahu na i ka sqaruar në Librin e Tij dhe në Sunetin e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Disa cilësitë e zemrës së njeriut janë:

1. Luhatja

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: *“Zemra e birit të Ademit është më e luhatshme se tenxherja në valë”*¹⁰.¹¹ Paqëndrueshmëria e zemrës është dëshmi për nevojën dhe dobësinë e saj. Askush nuk ka siguri nga ndryshmi i gjendjes së saj.

2. Vullneti

¹⁰ Zemra luhetet e gëlon më shumë se tenxherja ku zien dhe valon uji, qumshti, gjella etj. Pra, ajo është shumë e luhatshme dhe e paqëndrueshme.

¹¹ Ahmedi nr. 23867. Shejh Albani pohon se hadithi është autentik.

Vullneti është fuqia e zemrës, nëpërmjet të cilit ajo lëviz: dashuron, frikësohet, përparon dhe tërhiqet. Çdo zemër dëshiron ose të mirën, ose të keqen, sikurse thotë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): *“Emrat më të vërtetë janë Harith dhe Hamam.”*¹²

Ibn Tejmija thotë: “Harith do të thotë aktiv e fitues, ndërsa Hamam do të thotë ambicioz. Ambicia është dëshira e fortë që i paraprin vullnetit. Njeriu gjithmonë ka dëshira; çdo dëshirë duhet të ketë një pikësynim, që është qëllimi i fundit ku do të arrijë. Kështu që, çdo rob ka një pikësynim kryesor që dëshiron ta realizojë, sikurse ka vullnet ¹³ për ta arritur pikësynimin e tij. Kush nuk adhuron Allahun

¹² Ebu Daudi nr. 4950. Shejh Albani pohon se hadithi është autentik.

¹³ Aftësia që ka njeriu si veti të brendshme dhe këmbëngulja e tij për të arritur një qëllim a synim të caktuar, për të plotësuar një dëshirë ose për të kapërcyer vështirësitë e pengesat me përpjekje të vetëdijshme, me vendosmëri, me durim etj. (Fjalori i Gjuhës Shqipe)

me vullnet të hekurt dhe dashuri të zjarrtë, teksa e ka çmendur mendjemadhësia, ky patjetër do t'i nënshtrohet dikujt tjetër përveç Allahut, e humbet lirinë dhe pranon të skllavërohet nga krijesat.”¹⁴

3. Dashuria

Njeriu ka në zemër një dashuri të zjarrtë që e vë në lëvizje vullnetin e tij. Zemra nuk bën asgjë pa u motivuar nga dashuria. Allahu e krijoi zemrën e njeriut, që nëpërmjet saj të dojë Zotin e tij, për pasojë, t'i bindet, t'i përulet e t'i nënshtohet Atij, të respektojë urdhrat e Tij dhe të braktisë çdo gjë që Ai ia ka ndaluar.

Ibn Tejmija thotë: “Është krejt e qartë se zemra është krijuar për përmendjen Allahut të Lartësuar.”¹⁵

¹⁴ El Fetaua el kubra (10/169).

¹⁵ El Fetaua el kubra (5/51).

Ushtrime

1. Plotësoni vendet bosh.

a. Armiku që përpiqet ta shmangë njeriun nga adhurimi i Zotit të tij është:

.....
.....

b. Kur robi ka mangësi në adhurim, atëhere Allahu e mëshiron dhe në kthen të rrugën e drejtë nëpërmjet.....

2. Duke njohur zemrën tuaj (cilësitë e saj), qarkoni përgjigjen e saktë:

- a. luhatja,
- b. vullneti,
- c. kryeneçësia,
- d. vendosmëria.

Mësimi i pestë:

Baza dhe thelbi i adhurimit

Baza dhe thelbi i adhurimit janë ndjeshmëria dhe përvullësia e zemrës, që do të thotë se ajo duhet të jetë e nënshtroar dhe e përvullur ndaj Zotit të Lartësuar. Kur zemra i nënshtrohet dikujt, bie nën pushtetin dhe varësinë e tij. Kështu pra, zemra është skllav i atij që e zotëron, sikurse Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e quajti “rob” atë ka krijuar varësi ndaj disa gjërave: *“Mallkuar qoftë robi i dinarit dhe dirhemit, i rrobës dhe i pëlhurës!”*¹⁶

Kush e zotëron zemrën, quhet zotëriu i saj. Ti je rob i atij që sundon zemrën tënde. Shiko se rob i kujt je!

¹⁶ Buhariu nr. 2886.

Konkluzion

Përderisa zemra është nevojtare për atë që e ka nën zotërim, është detyrë e besimtarit që gjatë gjithë jetës së tij të mos ia ketë nevojën askujt përveç Allahut, për të qenë vetëm rob i Tij.

Çfarë ka pas përlësisë dhe nënshtrimit të zemrës?

Pasi zemra i përulet e i nënshtrohet Allahut, i bindet dhe i dorëzohet Atij, vjen momenti që ajo i respekton urdhrat e Tij me vetëdije, duke kërkuar ndihmë e duke iu mbështetur Atij. Është dashuria për Allahun ajo që e vë në lëvizje, për të realizuar me sukses gjithë këto procese jetësore. Me kalimin e kohës, kjo dashuri rritet dhe forcohet. Shihni pra se çfarë rezultate të mrekullueshme vijnë si pasojë nënshtrimit të zemrës ndaj Allahut!

Ndjenjat e zemrës janë adhurim

Zemra ka ndjenja. Ajo ndjen: dashuri, frikë, shpresë, nevojë, përlësi, nënshtrim etj. Ato duhet t'i kushtohen vetëm Allahut. Këto ndjenja duhet të përkthehen patjetër në vepra.

Lëmosha është provë e vërtetësisë së ndjenjave

Në një hadith është transmetuar se *“lëmosha është provë e besimit.”*

Shpjegimi i hadithit: Në zemrat tona kemi ndjenja të ndryshme për Allahun, si: dashuri, frikë, shpresë, nevojë, kënaqësi etj. Këto ndjenja ne i shfaqim duke ndarë lëmoshë për të varfërit. Lëmosha është provë, që dëshmon se dashuria jonë për Allahun është më e fortë se dashuria për pasurinë; ne i frikësohemi Allahut më shumë sesa varfërisë; ne shpresojmë te Allahu më shumë sesa te të tjerët përveç Tij. Prandaj ne ndajmë zekatin dhe lëmoshën për hir të Allahut,

duke iu bindur Atij me përrulësi e nënshtrim, duke zbatuar me përkushtim absolut sheriatin e Tij. Ne besojmë se pasuria dhe gjithë të mirat që gëzojmë janë dhuratë prej Allahut, i Cili meriton të sakrifikojmë më shumë për hir të Tij. Duke bërë analogji me lëmoshën, mund të flasim edhe për ndjenjat që e shoqërojnë besimtarin gjatë kryerjes së adhurimeve të tjera.

Konkluzione

1. Adhurimet që kryen nëpërmjet gjymtyrëve janë shprehje e vërtetimit i ndjenjave të përruljes, nënshtrimit dhe adhurimit të Allahut, që gjenden në zemër.

2. Adhurimet e ligjëruara nga sheriati duhet të prodhojnë nënshtrimin e zemrës ndaj Zotit, Mbrojtësit të saj, të Cilit i mbështetet.

Shkalla e adhurimeve ndryshon në varësi të nënshtrimit të zemrës

Sa më e nënshtruar dhe e përvetur të jetë zemra ndaj Allahut, sa më e fortë të jetë mbështetja dhe shpresa tek Ai, frika ndaj Tij, natyrisht, aq më i lartë është tek Allahu niveli i adhurimeve të gjymtyrëve dhe pranimi i tyre prej Tij, sepse Allahu vështron zemrat, nënshtrimin dhe përvetësinë e tyre ndaj Tij. Për këtë arsye, ndodh që 1 dirhem t'i paraprijë 100 000 dirhemëve.¹⁷ Gjithashtu, në një hadith është transmetuar se Allahu i Lartësuar ia fali gjynahet një gruaje imorale,¹⁸ e cila ia shuajti etjen një qeni, sepse në

¹⁷ Në hadith sqarohet shkaku përse 1 dirhem i paraprin 100 000 dirhemëve. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): *“Një dirhem është më i vlefshëm se njëqind mijë dirhem.”* Sahabët të habitur thanë: *“E si është e mundur kjo?!”* Ai tha: *“Një person kishte vetëm dy dirhemë dhe e dha sadaka njërin prej tyre, ndërsa një tjetër shkoi tek pasuria e tij e madhe, mori prej saj njëqind mijë dirhem dhe i dha sadaka.”* (Transmeton Nesaiu nr. 2527) (shën. përkth.)

¹⁸ Buhariu nr. 3467, Muslimi nr. 2245.

zemrën e saj kishte shqeritet, nënshtrim dhe përvulësi ndaj Tij.

Ushtrime

1. Kolegu juaj ju tregoi për luhajtjen e mendimeve dhe praninë e disa vesveseve në zemrën e tij. Ndhmojeni të zgjidhë problemin.

.....

.....

2. Pasi u njohë me ndjenjat që e shoqërojnë besimtarin gjatë kryerjes së bamirësisë, a mund të flasësh për ndjenjat që duhet ta shoqërojnë atë gjatë agjërimit?

.....

.....

.....

Mësimi i gjashtë:

Allahu nuk adhurohet veçse me sheriatin e Profetit Muhamed

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Prej mëshirës së Allahut ndaj nesh është që Ai caktoi për ne mënyrat përmes të cilave e shprehim dashurinë, nënshtrimin dhe përulësinë, bindjen, frikërespektin dhe dorëzimin tonë ndaj Tij. Allahu është Mbreti i mbretërve; për të arritur deri tek Allahu dhe Xheneti i Tij, ka vetëm një rrugë, të cilën Ai na e ka treguar nëpërmjet të dërguarve të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!), i fundmi i të cilëve është Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Kush dëshiron apo kryen adhurime që nuk pajtohen me metodën e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ky ka ndjekur një rrugë të kundërt, për të arritur deri tek Allahu, jo atë që ia ka përcaktuar Ligjvënësi. Kjo

bie në kundërshtim me adhurimin vërtetë; në këtë mënyrë nuk fitohet kënaqësia e Allahut dhe Xheneti i Tij:

(قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ)

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë”. (Al Imran: 31)

Kush nuk e pëlqen rrugën time, nuk është prej meje¹⁹

¹⁹ Pjesë e shkëputur nga hadithi që gjendet në “Sahihun” e Buhariut. Teksti i plotë i hadithit është: “Tre njerëz prej të afërmve erdhën në shtëpitë e grave të Pejgamberit (a.s.) dhe pyetën për ibadetin e Pejgamberit (a.s.). Pasi morën përgjigje, atyre iu duk se kjo është pak, prandaj thanë: “Ku jemi ne e ku është Pejgamberi (a. s.)?! Allahu ia ka falur atij të gjitha mëkatet.” Ndërkaq, njëri prej tyre tha: “Unë do të falem përherë tërë natën.”; i dyti tha: “Unë do të agjëroj vazhdimisht çdo ditë.”; i treti tha: “Unë do të distancohem nga gratë dhe

Tre të rinj vendosën të bëjnë gjëra të pazakonta në jetën e tyre, duke pretenduar se në këtë mënyrë shprehin përkushtimin ndaj Allahut dhe fitojnë kënaqësia e Tij. Njëri prej tyre tha: *“Unë do të falem përherë tërë natën.”*; i dyti tha: *“Unë do të agjëroj vazhdimisht çdo ditë.”*; i treti tha: *“Unë do të distancohem nga gratë dhe kurrë nuk do të martohem.”*

Çfarë i shtyu këta të rinj të marrin të tilla vendime ekstreme? Arsyeja është se ata e keqkuptuan adhurimin. Sipas tyre, të jesh adhurues i përkushtuar ndaj Allahut, do të thotë të shtosh sasinë e adhurimit dhe t’ia vështirësosh vetes mënyrën e jetesës. Kjo është një analogji e

kurrë nuk do të martohem.” Kur erdhi i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha atyre: “Ju jeni ata që keni thënë kështu dhe ashtu?! Ndërsa unë, Vallahi (për Zotin), i frikësohem Allahut më shumë dhe jam më i devotshëm ndaj Allahut sesa ju, por unë agjëroj dhe ha ushqim, falem dhe fle, si dhe bëj jetë bashkëshortore! Kush nuk e pëlqen rrugën time, nuk është prej meje .” (Buhariu pj. 15, fq. 493) (shën. përkth.)

gjymtuar²⁰.

Ndërsa i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) sqaroi se adhurim i vërtetë është ai që bazohet në Traditën Profetike; përcaktimi i tij nuk është lënë në dorë të njerëzve, të dëshirave e shijeve të tyre, sepse Allahu është më i Mëshirshëm ndaj njerëzve sesa ata ndaj vetes së tyre.

Ai ishte në shërbim të familjes së tij

Vallë, çfarë bënte Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur ishte në shtëpinë e tij?! Kjo pyetje zgjoi kureshtjen e Esuedit (Allahu e mëshiroftë!), prandaj ia drejtoi atë Aishes (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!), e cila iu përgjigj: *“Ishte në shërbim të familjes së tij. Ndërsa kur vinte koha e namazit, ai shkante të falej në xhami.”*²¹

²⁰ Mënyrë arsyetimi që mbështetet vetëm te mendja dhe jo te tekstet e shenjta (sheriati islam). (shën. përkth.)

²¹ Buhariu nr. 676.

Ky veprim i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tregon se adhurues i përkushtuar është ai i cili vepron çfarë dëshiron Allahu, pikërisht në momentin që është duke përjetuar. Kështu pra, kur je në familjen tënde, adhurimi më i mirë është shërbimi ndaj familjarëve të tu dhe plotësimi i nevojave të tyre; kur të vjen ndonjë mik për vizitë, i jep përparësi mikut ndaj familjes, e nderon dhe e respekton atë; kur thirret ezani, adhurimi më i mirë është falja e namazit etj. Kjo është hapësira e gjerë e adhurimit, që përputhet me kuptimin e emrit të Allahut *El Uasiu'* (Bujar i madh, i gjerë në mirësi).

Allahu është qëllimi dhe Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është mjeti

Ibn Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:
“Lëvizjet e robit adhurues duhet të kenë patjetër një qëllim të caktuar; gjithashtu, për të realizuar këtë qëllim, duhet të përdorë mjetin e duhur. Qëllimi është Allahu, ndërsa mjeti është Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin

mbi të!). E gjithë çështja qëndron te shehadeti (dëshmia): LA ILAHE IL-L ALLAH (nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Allahut), dhe dëshmia: MUHAMEDUN ABDUHU UE RESULUHU (Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij).”²²

Dy janë llojet e hixhretit (emigrimit):

1. Hixhreti drejt Allahut.
2. Hixhreti drejt të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Rregull

Allahu nuk ka urdhëruar bindje absolute ndaj askujt, përveçse ndaj Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

²² Xhamiu’ el mesail (8/27).

Hixhreti drejt Allahut

Hixhreti drejt Allahut realizohet përmes lutjes, dashurisë dhe adhurimit kushtuar Atij; gjithashtu, duke u mbështetur fuqimisht tek Ai; po ashtu, përmallimi, frika, shpresa, përulësia, dorëzimi, nënshtrimi, kërkimi i strehimit tek Ai dhe kthimi i sinqertë në rrugën e Tij; në çdo moment duhet të ndjesh se ke nevojë për Të²³. Kushdo që ka këtë sjellje, është muhaxhir i vërtetë që udhëton drejt Allahut. Ky është hixhreti i vërtetë që e do Allahu i Lartësuar.

Hixhreti drejt të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Të bësh hixhret drejt të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të thotë që të gjitha veprimet e mosveprimet të adhuruesit, qofshin ato të dukshme apo të fshehta, të jenë në përputhje me sheriatin e tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i cili është shtjellim i detajuar i çdo gjëje që Allahu

²³ Tariku el hixhratejni fq. 7.

e pëlqen dhe e do. Allahu nuk pranon fe tjetër, përveç fesë së tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).²⁴ Kështu pra, hixhreti drejt të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) realizohet duke vepruar në përputhje të plotë me sheriatin e tij dhe duke e ndjekur atë me konsekuencë.

²⁴ Referenca e mëparshme.

Ushtrime

1. Shoku yt përpiqet me të gjitha fuqitë të adhurojë Allahun me përkushtim. Madje, ai falet edhe në kohët e ndaluara dhe agjëron dy ditët e bajrameve. Cili është mendimi juaj për përpjekjet e tij në adhurim? Cila është këshilla juaj për të?


.....

.....

.....

2. Konstatoni adhurimin e duhur në situatat e mëposhtme:

- a. Kur ju vjen për vizitë një mik.
- b. Gjatë qëndrimit tuaj me prindërit.
- c. Kur vjen koha e namazit.
- d. Kur jeni me gratë dhe femijët tuaj.
- e. Ditët e festave.



Nënshtrimi

është cilësia më e veçantë e robit

Robi ka shumë cilësi, më e veçanta e të cilave është nënshtrimi ndaj zotëriut të tij. Zotëri i zgjuar është ai i cili kërkon një rob të nënshtuar, sepse nënshtrimi është baza e pjesës tjetër të cilësive. Nga nënshtrimi varet dhe niveli i shërbimit ndaj zotëriut, dashuria ndaj tij dhe fanatizmi për ta mbrojtuar atë dhe për të zbatuar urdhrat e tij. S'ka dyshim se Allahut i takon shembulli më i lartë.

Ti i nënshtrohesh atij që zotëron zemrën tënde

Ibn Tejmije thotë: “Kushdo që e lidh zemrën me krijesat, duke shpresuar në udhëzimin dhe ndihmën e tyre apo mbështetet tek ata, për sigurimin e mjeteve të jetesës, nuk ka dyshim se zemra e tij i është nënshtruar atyre. Në varësi të nënshtimit dhe përlësisë ndaj krijesave është dhe shkalla e skllavërimit ndaj tyre.”²⁵ Bazuar në këtë, ti je rob i bindur dhe i nënshtruar i atij që sundon zemrën tënde. Sigurisht, ajo që merret në konsideratë është zemra dhe jo aparenca. Burri i nështrohet gruas, kur ajo e sundon zemrën e tij, ndonëse në mënyrë të sipërfaqshme ai është zotëriu i saj. Gjithashtu, udhëheqësi që e lidh zemrën me njerëzit përreth tij, duke shpresuar në ndihmën e tyre, në të vërtetë ai është rob i nënshtruar ndaj tyre, ndonëse në pamje të jashtme është udhëheqës i tyre. Prandaj shikoni se kush e

²⁵ El fetaua el kubra (5/138)

sundon zemrën tuaj; ai është zotëria juaj, ndërsa ju jeni robër të tij.

Përsosmëria e adhurimit që kryen zemra është në nënshtrimin e saj ndaj Allahut

Kush dëshiron që ta shpëtojë zemrën e tij nga çdo e keqe, le ta mbushë atë plot e përplot me dashuri për Allahun dhe ta lidhë atë vetëm me Krijuesin e Tij Fuqiplotë, duke u mbështetur tek Ai për çdo gjë. Ky është adhurues i vërtetë i Allahut. Robi nuk mund ta arrijë përsosmërinë e adhurimit vetëm pasi ta shpëtojë zemrën nga çdolloj skllavërimi ndaj krijesave, duke iu përkushtuar vetëm Allahut të Lartësuar me të gjitha llojet e adhurimeve. Vetëm në këtë mënyrë gjen prehje e qetësi zemra e tij, siç thotë Allahu:

(إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ إِذَا ذُكِرَ اللَّهُ وَجِلَتْ قُلُوبُهُمْ وَإِذَا تُلِيَتْ عَلَيْهِمْ
آيَاتُهُ زَادَتْهُمْ إِيمَانًا وَعَلَىٰ رَبِّهِمْ يَتَوَكَّلُونَ)

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që, kur përmendet Allahu, u frikësohet zemra dhe, kur u lexohen ajetet e Tij, u shtohet besimi. Ata

kërkojnë mbështetje vetëm te Zoti i tyre.”
(El Enfal: 2)

Konkluzione

- 1. Të jesh plotësisht i bindur e i nënshtruar do të thotë të ndjesh qetësi ndaj atij që zotëron zemrën tënde.**
- 2. T’ia nështrosh zemrën Allahut do të thotë të ndjesh që je plotësisht në dorë të Fuqiptotit, nën pushtetin dhe zotërimin absolut të Tij.**

Ushtrim

Si mund ta marrësh vesh se diçka apo dikush e zotëron dhe e sundon zemrën tënde?

.....

.....

.....

Mësimi i tetë:

Nënshtimi i përhershëm ndaj Allahut

Në bazë të asaj që u shpjegua më parë në lidhje me kuptimin e nënshtimit, theksojmë se nënshtimi ndaj Allahut është një ndjenjë e përhershme e besimtarit, që e shoqëron atë në çdo kohë, në çdo moment e në çdo gjendje: kur është në gjumë dhe kur rri zgjuar, kur flet dhe kur hesht, kur është në këmbë dhe kur rri ulur, kur qesh dhe kur qan, në shtëpi, në punë e kudo etj.

Çfarë sjell nënshtimi ndaj Allahut, kur ai rrënjohet në zemër?

1. Besim

Kush i nënshtohet Allahut, i beson Atij në çdo gjë: në fjalët, në lajmet dhe historitë e Tij; beson

*në uluhijen dhe rububujen e Tij, në emrat dhe cilësitë e Tij.*²⁶

2. Dorëzim

Kush e ndjen se është në dorë të Allahut, nën pushtetin dhe sundimin e Tij, i dorëzohet Atij, i përmbush urdhrat e Tij dhe distancohet nga çdo gjë që ka ndaluar Ai.

3. Bindje

Robi adhures i bindet Allahut dhe udhëhiqet nga sheriatit i Tij, sepse zemra e tij është e nënshtruar ndaj Krijuesit Fuqiplotë.

²⁶ Besimi në *teuhidin uluhije* – njësimi i adhurimit vetëm për Allahun, duke ia kushtuar të gjitha adhurimet vetëm Atij.

Besimi në *teuhidin rububije* - njësimi i Allahut, duke besuar dhe pohuar veprat e Tij, si: krijimi, furnizimi, sundimi etj.

Besimi në *teuhidin esmau ue sifati* – njësimi i emrave dhe cilësive të Allahut. (shën. përkth.)

4. Vendosmëri dhe përkushtim

Ai që i nënshtrohet Allahut, është i vendosur në bindjen ndaj Tij, përmbush urdhrat e Tij dhe distancohet nga çdo gjë që ka ndaluar Ai; është i vendosur për t'iu përkushtuar fesë së Allahut dhe sheriatit të Tij me aq sa ka mundësi.

Shihni pra, sa mirësi sjell nënshtrimi! Nëpërmjet veprave të mira zemra pastrohet dhe bëhet adhuruese e përkushtuar ndaj Allahut. Kështu arrijmë të njohim thellësinë e të kuptuarit të paraardhësve tanë të mirë, të cilët e konsideronin nënshtrimin themel të adhurimit, sepse nënshtrimi pasohet nga të gjitha punët e zemrës dhe të trupit. Kjo është e vërteta e konceptit “fjalët dhe veprimet e zemrës”, që artikulojnë ndjekësit e Traditës Profetike.

Ushtrím

Përmend frytet e nënshtrimit ndaj Allahut, kur ai rrënjohet në zemër.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Mësimi i nëntë:

Nënshttrimi ndaj Allahut është në lidhje të ndërsjellë me njohjen e cilësive të Tij

Nuk mund të ketë nënshttrim vetëm se pas njohjes së madhësisë së Allahut dhe vlerësimit të drejtë të Tij. Kjo nuk mund të realizohet vetëm se duke pasur dije të përpiktë për emrat e Allahut dhe cilësitë e Tij, përmes të cilëve (emrave) Ai na njeh me Vetën e Tij. *Teuhidi esmau ue sifat* (njësimi i emrave dhe cilësive të Allahut) është baza e teuhidit, i cili është përmendur në suren el Fatiha:

(الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ إِيَّاكَ نَعْبُدُ
وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ)

**“Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut,
Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit, Sunduesit të Ditës së Gjykimit.”**
(El Fatiha: 2-4)

Rregull

Adhurimi është në lidhje të ndërsjelle me njohjen e emrave dhe cilësive të Allahut.

Ndër emrat më të bukur të Allahut që kanë kuptime përmbledhëse

Kush dëshiron të arrijë pozitën e lartë të adhuruesit të përkushtuar, le të njihet me kuptimin e emrave të bukur të Allahut dhe cilësive të Tij të përsosura.

Nëse i mungon kjo, le të njihet me kuptimin e katër emrave: EL. ËUELU²⁷, EL AKHIRU²⁸, EDH-DHAHIRU²⁹, EL BATINU³⁰.

Nëse i mungon kjo, le të njihet me kuptimin e dy emrave: EL HAJU³¹, EL KAJUMU³².

²⁷ I Pari, para të Cilit nuk ka asgjë.

²⁸ I Fundit, pas të Cilit nuk ka asgjë.

²⁹ I Larti, i Dukshmi, mbi të Cilin nuk ka asgjë.

³⁰ I Afërti, i Padukshmi, Ai është më pranë se kushdo tjetër me dijen e Tij; nuk ka ndonjë pengesë ndërmjet Tij dhe krijesave të Tij.

Nëse i mungon kjo, le të njihet me kuptimin e hadithit *sejdu el istigfari* – forma më e mirë e kërkimit të faljes.³³

³¹ I Gjalli, i Përjetshmi.

³² Mbarëvajtësi, Mbajtësi i gjithçkaje, i Cili i mban të gjitha krijesat, i rregullon çështjet e tyre, i ruan dhe kujdeset për to.

³³ Hadithi që tregon formën më të mirë të kërkimit të faljes është:

اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ، وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا
اسْتَطَعْتُ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ، أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ، وَأَبُوءُ لَكَ بِذُنُوبِي؛
فَاغْفِرْ لِي؛ فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ

All-Ilâhum-me Ente Rrab-bî, lâ ilâhe il-lâ Ente ħalaktenî ue ene abduke, ue ene alâ ahdike ue ua'dike masteta'tu, eûdhu bike min sherr-ri mâ sena'tu, ebû'u leke bi ni'metike alej-je, ue ebû'u bi dhenbî, fegfirr lî fe in-nehu lâ jegfirrudh-dhunûbe illâ Ente.

(O Allah! Ti je Zoti im! Askush nuk meriton të adhurohet, përveç Teje! Ti më krijove dhe unë jam robi Yt! Unë do t'i qëndroj besnik besës dhe premtimit që të kam dhënë, sa të mundem! Kërkoj të më mbrosh nga e keqja që vjen si pasojë e asaj që kam bërë! Të jam mirënjohës për të gjitha mirësitë që më

A është adhurim ndaj Allahut çdo nënshtrim në zemër?

Njeriu mund t'i nënshtrohet e t'i dorëzohet sunduesit të tij, i cili e ka mposhtur me dhunë, ndonëse ai e urren atë (sunduesin). Prandaj, te adhurimi duhet të sinkronizohen patjetër dy gjëra: përsosja e nënshtrimit me përsosmërinë e dashurisë.

kë bërë dhe i pranoj gjynahet e mia, prandaj më fal, sepse, në të vërtetë, gjynahet nuk i fal askush tjetër, përveç Teje!
(Buhariu)

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) {ka thënë se kjo është forma më e mirë e istigfarit dhe} se: *“Kushdo që e thotë këtë lutje kur gdhihet, duke qenë i bindur në të, dhe vdes në këtë ditë, ai hyn në Xhenet, dhe kushdo që e thotë kur ngryset, duke qenë i bindur në të, dhe vdes në këtë natë, ai hyn në Xhenet”*.
(shën. përkth.)

Zemra që i nënshtrohet Allahut, patjetër do ta dojë Atë. Kështu shtohet dashuria për Allahut, derisa ajo pushton gjithë zemrën dhe nuk lë në të vend për dashurinë e tjetërkujt, përveç Tij. Ndërkaq, adhurimi “ngjyros” zemrën e besimtarit; ai jeton në parajsën e dynjasë; shpirti i tij ngjen prehje e qetësi vetëm te Allahu dhe jeta e vdekja e tij janë të gjitha për Allahun, siç është transmetuar në hadithin kudsij (të shenjtë): *“Pasi ta dua, jam Unë dëgjimi i tij me të cilin dëgjon, vështrimi i tij me të cilin vështron, dora e tij me të cilën mëshon, këmba e tij me të cilën ecën. Atëhere, po më kërkoj, me siguri që do t’ia jap çfarë dëshiron; dhe po u strehua tek Unë, medoemos do ta mbroj.”*³⁴

Konkluzion

Nuk ka adhurim pa sinkronizuar përruljen e nënshtrimin ndaj Allahut me dashurinë ndaj Tij.

³⁴ Buhariu nr. 6138.

Ushtrim

Jo çdo nënshtrim në zemër është adhurim ndaj Allahut.

Shpjegoni këtë shprehje në dritën e kuptimit tuaj për adhurimin.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Kapitulli i dytë:

**Rebelimi
kundër adhurimit të Allahut**



Mësimi i parë:

Çfarë ka mbetur nga gjynahet tona?

Ka shumë hadithe që tregojnë se adhurimet i shlyejnë gjynahet. Kështu, për shembull, abdesi i shlyen gjynahet; pesë namazet ditore shlyejnë gjynahet që bëhen ndërmjet tyre; namazi i xhumasë i shlyen gjynahet e javës - nga xhumaja në xhuma; agjërimi në muajin e ramazanit i shlyen gjynahet e vitit - nga ramazani në ramazan; haxhi dhe umra i shlyejnë gjynahet e mëparshme; agjërimi i ditës së Ashures i shlyen gjynahet e vitit të kaluar; agjërimi i ditës së Arafatit i shlyen gjynahet e dy viteve. Pas gjithë këtyre amnitive, **çfarë ka mbetur nga gjynahet tona?**

Në fakt, kjo pyetje vjen si rezultat i keqkuptimit të adhurimit, përkushtimit dhe nënshtrimit ndaj Allahut. Sepse, kur robi i lutet Allahut për faljen e gjynaheve dhe shlyerjen e mëkateve, nuk mund

të imagjinojë vetëm se mëkatet e mëdha, si: idhujtaria, vrasja, vjedhja, konsumimi i alkoolit etj., prej të cilave është i distancuar. Prandaj, në momentin kur kërkon falje, ai ka ndjenja të ftohta.

Gjithashtu, kur kryen adhurimet e detyrueshme, si: namazi, agjerimi etj., ai mendon se nëpërmjet tyre e shkarkon veten nga detyrimi dhe përgjegjësia; e ka bërë punën që i takon. Ndërkaq, nuk e di se performanca e dobët, me ngjyrimet harrese e pakujdesie, konsiderohet gabim e gjynah; nuk e di se është e padenjë që t'ia paraqesë adhurimin Allahut me këtë performancë.

Injoranca e robërve dhe padrejtësia e tyre ndaj vetvetes

Në një hadith kudsij, Allahu i Lartësuar thotë:
“O robërit e Mi! Me të vërtetë, ju gaboni natën dhe

ditën, ndërsa Unë i fal të gjitha mëkatet. Prandaj, më kërkon falje që t'ju fal!”³⁵

Unë i kam bërë shumë padrejtësi vetes

Kur Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) i kërkoi Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të zgjedhë për të një lutje që i përshtatet, ai i tha: *“Thuaj:*

*اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا , وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ ,
فَاغْفِرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ وَارْحَمْنِي , إِنَّكَ أَنْتَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ.*

“O Zoti im! Unë i kam bërë shumë padrejtësi vetes! Askush tjetër, përveç Teje, nuk i fal gjynahet; prandaj të lutem më fal, më mëshiro, sepse Ti je Falësi i Madh dhe Mëshirëploti!”³⁶

Ky është një nga hadithet më mahnitëse, pasi përfytyroj se çfarë është ajo padrejtësi kaq e madhe që e pranon Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), teksa i lutet Zotit të tij që t'ia falë?! Ndërkaq, ne e dimë statusin e Ebu Bekrit në Islam.

³⁵ Muslimi nr. 2577.

³⁶ Muslimi nr. 2705.

Këtë padrejtësi nuk mund ta pranosh vetëm pasi e njeh mirë madhështinë e Allahut dhe adhurimin e pafund, të fshehtë e të dukshëm, që Ai meriton, adhurim që shtrihet në tërë hapësirën kohore. Sepse, është e drejtë e Allahut të përmendet e të mos harrohet, të respektohet e të mos kundërshtohet, të falënderohet dhe të mos përbuzen mirësitë e begatitë e Tij. Çdo mangësi në këto drejtime, është padrejtësi ndaj vetvetes. Çdo çast që kalon në shkujdesje e shpërfillje të plotë ndaj adhurimit të Allahut, konsiderohet padrejtësi ndaj vetes. Prandaj, nuk mund të mos thuash:

اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا كَثِيرًا

“O Zoti im! Unë i kam bërë shumë padrejtësi vetes!”

Ushtrim

Cila është ajo padrejtësi e madhe që e pranon Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) dhe i lutet Zotit të tij që t'ia falë?

.....

.....

.....

.....

.....



Mësimi i dytë:



Rebelimi kundër adhurimit të Allahut

Mëkati më i rëndë që bën rob ndaj Allahut është rebelimi kundër pozicionit të përshtatshëm të cilin ia ka përcaktuar Krijuesi i Lartësuar, që konsiston të *ubudija*³⁷, teksa ai kalon në pozitën e Zotit Fuqiptotë. Në këtë kontekst lexoje hadithin kudsij, në të cilin Allahu i Lartësuar thotë:

*“Krenaria dhe madhështia janë petku Im³⁸. Ai që më rivalizon në njërin nga këto të dyja, Unë do ta dënoj.”*³⁹

Zemërimi i Allahut ndaj arrogantit u shtua shumë, sepse ai u rebelua kundër statusit i “të qenit rob” dhe donte ta rivalizonte Allahun në atë që është e drejtë ekskuzive e Tij.

³⁷ Të qenit rob adhurues i Allahut.

³⁸ Janë cilësi absolute që më takojnë vetëm Mua, të pandashme prej Meje, ashtu si veshja në raport me trupin. (shën. përkth.)

³⁹ Muslimi nr. 2620.

Allahu është EL MUTEKEBIRU ⁴⁰ , EL MUTEA'LU⁴¹. Kryelartësia është e lavdëruar në të drejtën e Tij dhe e dënueshme në të drejtën e robit.

Rebelimi kundër *ubudijes*⁴² nëpërmjet fjalës

Një burrë tha: “*Betohem në Allahun se Ai nuk e fal filanin. Për këtë arsye, Allahu ia asgjësoi veprat atij.*”⁴³ Përse Allahu ia asgjësoi veprat këtij e jo të tjerëve, ndonëse një pjesë e tyre kryenin gjynahe të mëdha?! Sepse ai tha: “*Betohem në Allahun se Ai nuk e fal filanin.*”, duke shprehur rebelim kundër pozicionit të tij si rob adhures. Robit nuk i lejohet të thyejë rregullat e zotëriut të tij dhe as t'i japë vetes pozitën e atij që e ka nën sundim, i cili fal dhe dënon. Prandaj, zemërimi i Allahut ndaj tij u shtua shumë dhe ia asgjësoi veprat.

⁴⁰ Madhështori, i Madhërishmi, më i Madhi.
(shën. përkth.)

⁴¹ I Lartësuar i mbi të gjitha krijesat e Tij, me fuqinë e pushtetit të Tij. (shën. përkth.)

⁴² Të qenit rob adhures i Allahut.

⁴³ Muslimi nr. 2620.

Konkluzion

Bëni kujdes në fjalët e veprat tuaja; mos u rebeloni kundër pozicionit tuaj të duhur, që është *ubudija* - të qenit rob adhurues.

Sekreti i gëzimit të Allahut, për shkak të pendimit të robit

Allahu gëzohet kur pendohet robi, duke qenë se ai kthehet në pozicionin e duhur, për të cilin është krijuar: një rob i përulur dhe i nënshtruar vetëm ndaj Allahut, i penduar për pakujdesinë e treguar në të shkuarën dhe i vendosur për të mos u kthyer në rebelim në të ardhmen. Nga kjo ndjenjë lindin të gjitha aktet e bindjes dhe veprat e mira.

Rregull etik

Kush e njeh veten, e njeh Zotin.

Ai që njeh dobësinë e vetes, njeh forcën e Zotit; kush njeh aftësitë e tij të kufizuara, njeh fuqinë

absolute të Zotit. Ai e di mirë se është rob i përulur, ndërsa Zoti është Madhështor e Krenar; ai është i paditur, ndërsa Zoti është i Gjithëdituri. S'ka dyshim se Allahu i Lartësuar është i Vetmi që zotëron të gjitha atributet e përsosmërisë; Atij i takojnë të gjitha falënderimet dhe lavdërimet. Allahu është i Madhëruari, i Vetëmjaftueshmi. Ai nuk ka nevojë për krijesat, ndërsa gjithë krijesat kanë nevojë për Atë; robërit janë të varfër, kanë nevoja, të meta e mangësi. Sa më shumë të dije për të metat e mangësitë, për varfërinë, përulësinë dhe dobësinë e tij, aq më shumë e njeh Zotin me atributet e Tij të përsosura.⁴⁴

Vetëmburrja është defekt në adhurim

Allahu i Lartësuar thotë:

(فَلَا تُزَكُّوا أَنْفُسَكُمْ)

“Prandaj, mos e mburrni veten!” (En-Nexhm: 32)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: *“Nëse përballeni me*

⁴⁴ Medarixhu es-salikin (1/427).

ata që lavdërojnë veten, u hidhni atyre dhe' në fytyrë."⁴⁵
Gjithashtu është lutur: *"Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga të këqijat e vetes sonë!"*⁴⁶ E gjithë kjo, në mënyrë që robi të mos e mburrë veten dhe të mos rebelohet ndaj pozicionit që duhet të mbajë si adhurues i përkushtuar ndaj Allahut. Robi nuk duhet të mbështetet në fuqitë e tij, ta çmojë veten më lart se të tjerët dhe mbahet me të madh, se kjo, për pasojë, sjell zmadhimin e të mirave të vetes në sytë e tij dhe zvogëlimin e të këqijave. Kështu atij patjetër do t'i pëlqejë vetja. Në fakt, kjo është shmangie nga pozicioni i adhuruesit dhe përdhosje e attributeve të tij. Në këtë mënyrë, ai e ekspozon veten ndaj urrejtjes dhe zemërimit të Allahut të Lartësuar.

Varfëria dhe nevoja për Zotin

"O robërit e Mi! Ju të gjithë jeni të humbur, përveç atij që Unë e udhëzoj, prandaj kërkojeni udhëzimin prej

⁴⁵ Muslimi nr. 3002.

⁴⁶ Ebu Daudi nr. 2118, Tirmidhiu nr. 1105.

Meje, që t'ju udhëzoj. O robërit e Mi! Ju të gjithë jeni të uritur, përveç atij që e ushqej Unë, prandaj kërkonte prej Meje që t'ju ushqej, e Unë do t'ju ushqej. O robërit e Mi! Ju të gjithë jeni të zhveshur, përveç atij që e vesh Unë, prandaj kërkonte veshje prej Meje, që t'ju vesh."⁴⁷

Ushtrim

Përmendni disa shfaqje të rebelimit kundër *ubudijes* - të qenit rob adhures.

.....

.....

.....

.....

.....

⁴⁷ Muslimi nr. 2577.

Mësimi i tretë:

Konceptimi i drejtë i shkaqeve të ligjërara nga sheriati islam

Allahu nuk adhurohet vetëm se nëpërmjet kryerjes së shkaqeve që ka ligjëruar Ai. Shejtani përpiqet ta devijojë robin nga këto shkaqe nëpërmjet teprimit ose pakujdesisë, për ta rrëzuar nga pozita e lartë e adhurimit. Ashtu siç falet në mënyrën që e ka ligjëruar Allahu, po ashtu duhet ta kërkojë riskun duke u mbështetur plotësisht në Fuqploti, sepse edhe këtë të fundit Ai e ka ligjëruar dhe e ka bërë detyrë. Gjithashtu, droja, dashuria, shpresa duhet të jenë në përputhje të plotë me sheriatin e ligjëruar nga Allahu i Lartësuar. Edhe asketizmi nuk konsiderohet i ligjshëm vetëm nëse është në përputhje me sheriatin islam. Për çdo vepër e adhurim, shejtani përdor mjetet e taktikat e tij, për ta çuar robin në skajshmëri; këtë e realizon

ose nëpërmjet teprimit, ose përmes pakujdesisë. Robi adhures i përkushtuar ndaj Allahut duhet të kuptojë mirë shkaqet dhe veprimet që Zoti i tij ia ka lejuar dhe i pëlqen.

Mishërimi i adhurimit në kryerjen e shkaqeve

Kush kryen ndonjë shkak të caktuar, qoftë ky në kërkim të riskut, të dijës, të të mirave materiale apo bën ndonjë veprim me zemër, ta dijë se është duke adhuruar Allahun, nëse plotëson tre kushtet e mëposhtme:

- a. Të ndjejë në zemër bekimin e Allahut, i Cili ia mundësoi kryerjen e këtij shkakui.
- b. Ta kryejë shkakun apo veprimin në përputhje me urdhrin e Allahut, i Cili e urdhëroi ta kryejë atë (shkak a veprim) dhe e bëri ligj të Tij lidhjen e gjërave me shkaqet e tyre (lidhja shkak-pasojë).
- c. Të përpiqet të realizojë atë çfarë është në gjendje të bëjë, duke përdorur të gjitha

mundësitë që i ka krijuar Allahu. Kjo është një mënyrë për të shprehur falënderim ndaj Allahut, për mundësitë e kryerjes së shkaqeve. Për këtë arsye, Allahu e lavdëroi Dhulkarnejnin duke thënë: (ثُمَّ اتَّبَعَ سَبَبًا) "Pastaj ndoqi një rrugë tjetër (u nis sërish për udhë, pra, veproi duke bërë shkakun e duhur)." (El Kehf: 89)

Kështu pra, Dhulkarnenji nuk la pas dore kryerjen e shkaqeve; përkundrazi, ai bëri gjithçka që kishte mundësi.

Rregull

Mbështetja në Allahun jo vetëm që nuk përjashton kryerjen e shkaqeve, por e konsideron këtë kërkesë të domosdoshme.

Defekti në kryerjen e shkaqeve ka dy aspekte:

1. Teprimi

Mbështetja në shkaqet, zmadhimi i rëndësisë së tyre dhe animi i zemrës nga ato. Për të arritur qëllimin e tij, ai përdor çdo mjet dhe kryen çdo shkak, sidoqoftë i lejuar apo i ndaluar. Kjo është lakmi dhe pangopësi.

2. Pakujdesia

Nënvlerësimi i kryerjes së shkaqeve dhe mungesa e përpjekjeve për realizimin e tyre. Kjo është paaftësi dhe dembelizëm.

Ibn Kajimi e ilustron me një shembull raportin që kanë njerëzit me shkaqet

Ibn Kajimi solli një shembull, për ta bërë të qartë mënyrën si i trajtojnë njerëzit shkaqet. Ai thotë: “Është si një rrugë konkrete, ku udhëtari ecën drejt vendmbërritjes. Nëse atij i thuhet :

a. Hiq dorë nga udhëtimi dhe mos vazhdo të ecësh drejt destinacionit, ai do të tërhiqet plotësisht nga ky rrugëtim.

b. Dhe nëse e bën atë (rrugën - mjetin) qëllimin e vet dhe nëpërmjet rrugëtimit nuk ka për qëllim mbërritjen në destinacionin e caktuar, ai po devijon nga qëllimi, është i preokupuar me rrugën, duke e konsideruar atë qëllim në vetvete.

c. E nëse i thuhet: Vazhdo në rrugën tënde dhe kalo nëpër të gjitha stacionet e saj, por ec me kujdes, duke shikuar në drejtim të destinacionit dhe duke punuar për të arritur në të; pikërisht kjo është e vërteta.”

Ekulibër

Konceptimi i drejtë i adhurimit bën që të balancosh dy gjëra:

a. faktin që Allahu të ka urdhëruar të kryesh deri në fund e në mënyrën më të mirë shkaqet e duhura;

b. dhe zemra të mbetet gjithmonë e lidhur me Zotin, para dhe pas kryerjes së shkaqeve.

Ushtrim

Teprimi dhe pakujdesia janë dy forma të shfaqjes së defekteve në kryerjen e shkaqeve.

Jepni shembull për secilën formë nga jeta jonë e përditshme.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Mësimi i katërt:

Për hir të Allahut dhe me ndihmën e Allahut

Themeli i adhurimit konsiston në dy shprehjet kuptimplote:

1. për hir të Allahut,
2. dhe me ndihmën e Tij (duke u mbështetur në Allahun Fuqiplotë).

1. Për hir të Allahut

Qëllimi i të gjitha veprimeve tona duhet të jetë Allahu, arritja e kënaqësisë së Tij, sepse vetëm Ai e meriton adhurimin e përkushtimin, përulësinë e nënshtrimin. Ky është një ndër kuptimet e emrit EL AKHIRU – i Fundit, pas të Cilit nuk ka asgjë.⁴⁸ Allahu nuk i pranon veprat, nëse ato nuk janë të sinqerta për hir të Tij. I Lartësuar qoftë Ai!

⁴⁸ Siç thotë Allahu i Lartësuar në Kuran:

(كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ وَيَبْقَىٰ وَجْهَ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ)

2. Me ndihmën e Allahut (duke u mbështetur në Allahun Fuqiplotë)

Prej Allahut kërkohet ndihma dhe mbështetja; në dorën e Tij është forca e fuqia. Kur dëshirojmë të hamë, përmendim emrin e Allahut; në emër të Tij ndihmohemi; emrin e Tij përmendim dhe Atë e lavdërojmë, kur i hipim mjetit të udhëtimit, sepse është Ai që e nënshtroi këtë mjet për ne, përndryshe, vetë ne nuk do të kishim mundësi ta bënim këtë gjë. Ne shtrihemi për të fjetur duke përmendur emrin e Allahut; me fuqinë e Tij, jo me fuqinë tonë; me madhësinë e Tij absolute, jo me dobësinë dhe varfërinë tonë. Plotësoni veprimet e ditës suaj me këtë ndjenjë, pikërisht me ndjenjën e nënshtimit e të adhurimit.

“Çdo gjë që është në Tokë do të zhduket e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, që është i Madhëruar e Bujar.” (Er-Rahman: 26-27) (shën. përkth.)

Ai sjell buzëqeshjen dhe lotët ⁴⁹

Ajeti është argument që përforcon adhurimin tonë ndaj Allahut dhe rrit të kuptuarit tonë për të (adhurimin). S'ka dyshim se robi është nën sundimin dhe pushtetin e Allahut edhe kur qesh, edhe kur qan. Ai nuk qesh vetëm se me ndihmën e Allahut. Allahu krijoi tek njeriu dëshirën për të qeshur. Allahu kujdeset për qelizat dhe sistemin e tij nervor; i jep forcë dhe krijon kushtet për zhvillimin e këtij procesi (e qeshura). Allahu i fal njeriut ndjesinë e kënaqësisë e qetësisë, e bën atë të ndihet mirë e të qeshë. Sa të varfër e të dobët

⁴⁹ Allahu në Kuranin e madhërishëm thotë:

(وَأَنَّهُ هُوَ أَضْحَكَ وَأَبْكَى)

“Ai sjell buzëqeshjen dhe lotët.” (En-Nexhm: 43)

Në komentin e këtij ajeti, shejh Abdurahman ibn Nasir es-Sadij ka thënë: “Allahu është Ai që sjell në ekzistencë shkaqet që të bëjnë të qeshësh apo të qash. Ai ka krijuar të mirën e të keqen, gëzimin e lumturinë, frikën e trishtimin. Të gjitha këto, Allahu i lartësuar i ka bërë të ekzistojnë sipas dijes dhe urtësisë së Tij absolute.” (shën. përkth.)

jemi ne! Sa Madhështor, Bujar dhe i Fuqishëm është Zoti ynë i Lartësuar!

Konkluzion

Robi që përjeton të tilla ndjenja kur qesh në momente gëzimi, kurrsesi nuk mund të jetë i pakujdesshëm ndaj Zotit të tij, kur i ndodhin gjëra më të mëdha gjatë ditës dhe natës.

Allahu është Dhuruesi dhe Privuesi

Përmbushja e detyrës së adhurimit, kërkon që robi të jetë plotësisht i kënaqur me Zotin. Kur ju vjen diçka, dini se është prej Allahut; ndërsa kur privoheni nga diçka, dini se Allahu ju ka privuar nga ajo. Prandaj, ne themi:

“O Zoti ynë! Askush nuk mund të ndalë atë që jep Ti; dhe askush s’mund të japë atë Ti e ndal.”⁵⁰

Në këtë mënyrë largohet shqetësimi si pasojë e privimit; po ashtu, largohen euforia dhe murrja si rezultat i dhurimit.

Rregull etik

Pengesat që privojnë zemrën nga komunikimi me Allahun janë si idhujt që bllokojnë rrugën për tek Allahu. Prandaj, largojini idhujt tuaj!

⁵⁰ Kjo është pjesë e lutjes kur ngrihemi nga rukuja e namazit. Hadithin e transmeton Muslimi. (shën. përkth.)

Ushtrim

Çfarë kuptimi ka fjala jonë: “Për hir të Allahut dhe me ndihmën e Tij”?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Mësimi i pestë:

Kur dashuria shndërrohet në torturë

Allahu u dhuroi robërve bekimin e dashurisë dhe e bëri zemrën vatër të kësaj ndjenje sublime, nëpërmjet se cilës ata organizojnë jetën e tyre. Gjithashtu, Ai e bëri dashurinë ligj në mbretërinë e Tij. Kushdo që e shpërdoron bekimin e dashurisë, duke ia ndryshuar qëllimin për të cilin ekziston kjo dashuri, merr shpërblimin e merituar: dashuria shndërrohet në dhimbje e torturë, siç ndodh me ashikët, dashnorët e marrosur, dhe tek ata që kanë varësi afektive. Kjo dhimbje e brendshme vjen si qortim prej Allahut për zemrën që dëshiron ta nxjerrë dashurinë nga binarët e saj të drejtë: *“Ta dojë një person vetëm për hir të Allahut.”*⁵¹

⁵¹ Këto fjalë janë pjesë e hadithit të saktë që e transmeton Buhariu, në të cilin Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: *“Kush i ka tre gjëra, ai do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit: të jetë Allahu dhe*

I dashuruari dhe i dashuri adhurojnë njëri-tjetrin

Kushdo që dashuron dikë, gjithë vëmendjen e drejton te ai dhe zemra i rreh për të, kështu ai e adhuron të dashurin e tij. Nga ana tjetër, i dashuri, i cili është i kënaqur që ka rrëmbyer zemrat e njerëzve, dhe i janë nështruar atij, edhe ky, në këtë drejtim, është rob i atyre që e duan, sepse me të tilla ndjenja ai mbush zbrazëtinë e zemrës. Të gjitha zemrat janë për Allahun dhe përkushtimi i tyre ndaj dikujt tjetër, përveç Allahut, është sprovë.

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) më i dashur se çdo gjë tjetër, ta dojë tjetrin vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë kthimin në mosbesim, siç urren të hidhet në zjarr.” (shën. përkth.)

Të devotshmit dhe reagimi i tyre ndaj Shejtanit

Allahu i Lartësuar thotë për adhuruesit e devotshëm e të përkushtuar:

(إِنَّ الدِّينَ اتَّقُوا إِذَا مَسَّهُمْ طَائِفٌ مِّنَ الشَّيْطَانِ تَذَكَّرُوا فَإِذَا هُمْ مُبْصِرُونَ)

“Ata që janë të përkushtuar, kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli, përmendin Allahun e atëherë arrijnë të shohin rrugën e drejtë.”
(El A'raf: 201)

Disa nga dëshmitë e ajetit në lidhje me adhurimin:

- a. Të devotshmit bien në gjynahe, të cilat Allahu i ka caktuar për robërit e Tij.⁵²
- b. Shejtani nuk zë vend në zemrat e besimtarëve të devotshëm, por vetëm sa u qaset atyre me ndonjë mendim të lig.

⁵² Përveç të dërguarve të Allahut, askush nuk është imun (i mbrojtur) nga gjynahet. (shën. përkth.)

c. Sa shpejt reflekton i devotshmi dhe kthehet tek Allahu, duke u penduar dhe duke i kërkuar falje Atij!

d. Pas pendesës, lutjes dhe kërkimit të faljes, besimtari i devotshëm e shikon qartë rrugën e drejtë dhe e shton besimin.

e. Shejtani i sillet rrotull robit në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar ta lëndojë atë.

Konkluzion

Adhuresi i Allahut mëkaton, por nuk këmbëngul në mëkate. Ai e pranon gabimin, pendohet dhe i kërkon falje Zotit të tij.

Përrulje e shoqëruar me dashuri

Adhurimi i vërtetë realizohet nëpërmjet sinkronizimit të nënshtrimit me dashurinë vetëm për Allahun e Lartësuar. Njeriu mund të nështrohet ndaj dikujt, si rezultat i rrethanave imponuese. Çdo qenie në ekzistencë ka një formë nënshtrimi, për shkak se është krijesë e Zotit.

Gjithsesi, kur flasim për nënshtrimin ndaj Allahut, kemi për qëllim vënien në sinkroni të dy gjërave: nënshtrimin e përsosur me dashurinë e përkryer.⁵³ Vetëm Allahu është Ai që meriton dashuri e nënshtrim absolut.

Rregull etik

Sa më shumë rritet e forcohet dashuria për Allahun në zemër, aq më shumë shtohet nënshtrimi ndaj Tij. Dhe sa herë që zemra i nënshtrohet Allahut, aq më shumë e do Atë.

⁵³ Pra, nuk ka adhurim të vërtetë pa sinkronizuar përuhlen e nënshtrimin ndaj Allahut me dashurinë ndaj Tij. (shën. përkth.)

Ushtrim

Kur shndërrohet dashuria në torturë, nga e cila vuan shumë i dashuruari?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Mësimi i gjashtë:

Si të rritet dhe forcohet dashuria për Allahun?

Kjo është një pyetje e zgjuar dhe shumë e dobishme. Dashuria për Allahun rritet e forcohet nëpërmjet tri gjërave:

a. Mbushja e zemrës plot me dashuri vetëm për Allahun:

Kjo dashuri duhet të përshkojë çdo qelizë të zemrës dhe të gjymtyrëve, siç thotë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

“Allahu dhe Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të jenë për të më të dashur se çdo gjë tjetër.”

b. Pastrimi i zemrës nga çdo gjë që e njollos dashurinë e singertë për Allahun:

Teksa robi është duke ecur në rrugën drejt Zotit, në zemër mbijnë farërat e këqija të varësisë prej të tjerëve përveç Allahut të Lartësuar, prandaj ai duhet të përpiqet ta pastrojë zemrën nga çdo gjë që rivalizon dashurinë e sinqertë për hir të Allahut, siç thotë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): *“Ta dojë tjetrin vetëm për hir të Allahut.”*

c. Parandalimi i tradhtisë:

Të parandalojë çdo gjë që e urren apo nuk e pëlqen Allahu, siç thotë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): *“Të urrejë kthimin në mosbesim, siç urren të hidhet në zjarr.”*

Allahu duhet të jetë më i Dashuri, e, jo thjesht i Dashuri

Prej robit kërkohet që Allahu të jetë më i Dashuri, e, jo thjesht i Dashuri. Nuk mund të jetë më i Dashuri vetëm nëse dashuria ndaj Tij është e plotë dhe nuk e ndan atë asnjëherë me ndonjë

tjetër; të dojë gjithçka që do Allahu dhe të veprojë gjithmonë në përputhje me dëshirën e Tij. Pra, ai do çdo gjë që do Allahu; Allahu për të është i Dashuri absolut. Allahu është i Dashuri për shumë besimtarë, por çështja konsiston te dashuria e përkryer, si dhe sfida për të qenë Allahu më i Dashuri në zemrën tënde.

Adhurimi sjell seriozitet

Kush i nënshtrohet Allahut dhe e do Atë, kush përpiqet të fitojë kënaqësinë e Tij dhe të garojë me të tjerët në nënshtrimin ndaj Tij, këto qëllime sublime nuk mund t'i realizojë kurrë vetëm nëse ka dituri e vullnet, punë e vendosmëri. Sa herë që përfundon një adhurim, vazhdon me një adhurim tjetër, duke u përpjekur fort në të. Ai përdor çdo mjet që mundet, për t'u afruar tek Allahu. Në këtë kontekst, sahabët ishin njerëzit më të devotshëm e të përkushtuar ndaj Allahut, megjithatë, ata ecnin nëpër Tokë të qetë e me modesti; kur injorantët u drejtoheshin me fjalë fyese, ata përgjigjeshin me mirësi: "Paqe!". Këto

janë rezultatet praktike të adhurimeve, të kërkimit të ndihmës prej Allahut dhe dëshirës së sinqertë për të fituar kënaqësinë e Tij.

Ushtrim

Cilat janë ato gjëra që rrisin e forcojnë dashurinë e robit për Allahun?

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Mësimi i shtatë:

Disa rregulla për të kuptuar adhurimin

1. Të ndjesh thellë në zemrën tënde nevojën për Allahun:

Pasi e pastron dhe e ruan zemrën nga tekat dhe egoizmi, i përkushtohesh tërësisht adhurimit, për të fituar kënaqësinë e Zotit tënd.

2. Të ndjesh gjithmonë në zemër prezencën e Allahut:

Në jetën tënde të përditshme duhet të ndjesh se je në dorë të Allahut, nën pushtetin dhe sundimin e Tij. Ai dëgjon çdo fjalë që nxjerr nga goja dhe shikon çdo veprim që ti bën. Duhet të sillesh me Të ashtu si robi që vihet tërësisht në shërbim të zotëriut të tij dhe përpiqet të bëjë çdo gjë që do dhe pëlqen ai (zotëriu), i cili përkujdeset për të dhe i ka dhuruar mirësi.

3. Shpëtoni zemrën tuaj nga varësia e dikujt apo diçkaje tjetër përveç Allahut:

Kontrolloni zemrën tuaj dhe identifikoni sëmundjet e saj, që mund të jenë: lakmia për post, pozitë, famë e prestigj; gjithashtu, ajo mund të vuajë nga murrja, mendjemadhësia, kryelartësia dhe arroganca; shpesh i pëlqejnë lajkat e lavdërimet e pamerituara apo vrapon pas pasurisë, duke përdorur çdo mjet në kërkim të saj, ose është sprovuar me pasionin seksual... dhe të tjera sëmundje e varësi. Duke i kërkuar ndihmë Allahut, kuroji menjëherë të gjitha këto sëmundje dhe eliminoji të gjitha këto varësi. Zëvendësoji ato me adhurimin e sinqertë ndaj Allahut, duke e lidhur zemrën me Zotin tënd dhe fenë e Tij. Vepro çdo gjë që do dhe kënaqet Zoti yt!

4. Prano dobësinë dhe brishtësinë tënde:

Robi merr fuqi e furnizohet me energji nga zotëriu i vet. Allahu është Kujdestari yt. Në dorën e Tij është energjia, forca e fuqia, ndryshimi dhe lëvizja. Duke pranuar dobësinë

dhe brishtësinë tënde, ti shpëton nga mendjemadhësia, euforia e vetëmashtrimit. Ndërkaq, ke frikë se mos të braktisë Allahu; mund të lërë të mbështetësh në veten tënde të dobët, e, rrjedhimisht, pëson zhgënjim.

Ushtrim

Jepni nga një shembull për secilin prej katër rregullave, që ju ndihmojnë të kuptoni drejt adhurimin.

.....

.....

.....

.....

.....

Mësimi i tetë:

Koncepti i adhurimit në ajetin Kursij

Allahu i Lartësuar thotë:

(اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ ۚ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ ۚ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ ۗ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ ۚ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ ۗ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ ۚ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ ۗ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا ۚ وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ)

“Allahu është Një! Nuk ka të adhuruar tjetër (*me meritë*) përveç Tij. Ai është i Gjalli, i Përjetshmi (*El Hajju*), Mbarëvajtësi e Mbajtësi i gjithçkaje (*El Kajjumu*)! Atë nuk e kaplon dremitja e as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Ai, përveçse me lejen e Tij. Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dituria e Tij, përveçse aq sa dëshiron Ai. Froni (*Kursijj-i*) Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe

Atë nuk e lodh përkujdesja për të dyja. Ai është i Larti, Madhështori!” (El Bekare: 255)

Leximi i ajetit Kursij është ligjërues pas çdo namazi farz, në dhikrin e mëngjesit e të mbrëmjes, para gjumit etj., sepse ai mbart në vetvete shpjegime të çështjeve madhore, siç janë: adhurimi i Allahut dhe nevoja jetësore e krijesave për Të. Gjithashtu në këtë ajet Allahu i Lartësuar na njuh me Vetën e Tij, na tregon se jeta e Tij është e përsosur në çdo drejtim; Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe për asnjë përkujdesje, ndërkohë që gjithçka tjetër ka nevojë për përkujdesjen e Tij. Ai është i Gjallë e i Përrjetshëm, i Pavarur, që nuk ua ka nevojën krijesave. Ai i krijoi të gjitha qeniet dhe të gjitha varen prej Tij, mbështeten tek Ai. Allahu është Sunduesi e Pronari i gjithçkaje në qiej e në Tokë. Çdo gjë është e nënshtruar dhe pronë e Tij. Ai është Krijuesi e Furnizuesi, Administrues e Kujdestar i gjithçkaje. Krijesat nuk kanë në dorë asnjë grimcë pushteti, as në qiej dhe as në Tokë. Askush nuk mund të ndërmjetësojë tek Allahu, pa i dhënë lejë Vetë Ai,

Sunduesi i botës. Ndërmjetësimi dhe ndihma janë në dorën e Tij; shkaqet e veprimet bëjnë dobi vetëm me dëshirën e Tij. Allahu na tregon se njëra prej krijesave të Tij - *Kursija* përfshin qiejt dhe Tokën. *Kursija* nuk është krijesa më e madhe e Allahut. *Arshi*, për shembull, është shumë herë më i madh se *Kursija*. *Kursija* në raport me *Arshin* është si unaza (e hedhur) në shkretëtirë. Kush e lexon këtë ajet me zemër, me përqëndrim dhe duke medituar, patjetër që frymëzohet prej tij, i shtohet dhe i forcohet nënshtrimi, përkushtimi dhe dashuria për Allahun, vetëm tek Ai mbështetet, vetëm prej Tij druhet dhe vetëm në Ai shpreson.

Përmendja e Allahut përtërin besën që robi i ka dhënë Atij, për të qenë adhurues i përkushtuar ndaj Tij

Dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes përtërin premtimin që robi i ka dhënë Allahut, për të qenë gjithmonë adhurues i singertë ndaj Tij. Çdo

formë e dhikrit i kujton robit amanetin e adhurimit, të cilin e ka domosdoshmëri në jetën e tij, sepse për këtë qëllim është krijuar dhe ky është pozicioni i duhur i tij, si një krijesë nevojtare. Adhurimi është akti më sublim që e lidh robin me Krijuesin e Lartësuar, i Cili i ka dhuruar gjithë të mirat e begatitë. Përveç kësaj, dhikri e mirëmban pastërtinë e adhurimit dhe e ruan atë nga çdo gjë e dëmshme. Dhikri i mbyll para robit të gjitha dyert, përveç derës që e lidh me Zotin; kjo mbetet gjithmonë e hapur. Lexo tani, për shembull, lutjen:

بِسْمِ اللَّهِ الَّذِي لَا يَضُرُّ مَعَ اسْمِهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ وَهُوَ
الَسَّمِيعُ الْعَلِيمُ

**Bismil-lâhil-ledhî lâ jedurr-rru mea ismihi
shej'un fil errdi ue lâ fis-semâi ue hues-Semîul
'Alîm.**

*(Kërkoj mbrojtje me emrin e Allahut nga çdo keqberës,
emër ky me përmendjen e të cilit nuk mund të bëjë dëm
asgjë në tokë dhe asnjë sprovë që zbret nga qielli! Allahu*

*është Ai i Cili i dëgjon të gjitha thëniet dhe i di të gjitha gjendjet!)*⁵⁴

Lexoje me kujdes dhe medito rreth fjalëve: “...*me përmendjen e këtij emri (Allah) nuk mund të bëjë dëm asgjë...*”, pastaj përsiat fjalën “*asgjë*”. Kështu pra, emri i Allahut të Lartësuar është mirëqenie, shërim e shëndet, që nuk lë asnjë brengë, vuajtje e sëmundje në shpirt e në trup. Atje ku nuk përmendet emrin e Tij përqëndrohet helmi. Përsërite lutjen, pastaj do të shohësh se sa sëmundje do të largohen nga zemra jote. Pikërisht këto sëmundje ishin perdja e vendosur ndërmjet teje dhe nënshtrimit tënd ndaj Allahut të Lartësuar. Ndoshta kjo është urtësia e përsëritjes së këtyre lutjeve tre herë, që t’ia shtojë robit dijen dhe vullnetin e mirë, për të kuptuar domethënien madhështore që ato mishërojnë në vetvete.

⁵⁴ Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin me të!) ka thënë: “*Kush e thotë këtë dhikër tre herë kur të gdhijë dhe tre herë kur të ngryset, atij njeriu nuk do t’i bëjë dëm asgjë*”. (Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe) (shën. përkth.)

Ushtrim

Kur dhe ku është i pëlqyer leximi i ajetit Kursij?

.....

.....

.....

.....

.....

Mbyllje

Shembulli i robit dhe zotëriut të tij

Për të kuptuar konceptin e *ubudijes* – të qenit rob adhurues i Allahut, ju ndihmon shembulli i mëposhtëm. Le të mbetet gjithmonë i freskët në kujtesën tuaj shembulli i robit dhe zotëriut të tij. Ti je robi, ndërsa Allahu është Zoti yt i Lartësuar. Allahu na jep një shembull në Librin e Tij:

(ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا عَبْدًا مَمْلُوكًا لَا يَقْدِرُ عَلَى شَيْءٍ وَمَنْ رَزَقْنَاهُ مِنَّْا رِزْقًا حَسَنًا فَهُوَ يُنْفِقُ مِنْهُ سِرًّا وَجَهْرًا ۗ هَلْ يَسْتَوُونَ ۗ الْحَمْدُ لِلَّهِ ۗ بَلْ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْلَمُونَ وَضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا رَجُلَيْنِ أَحَدُهُمَا أَبْكَمُ لَا يَقْدِرُ عَلَى شَيْءٍ وَهُوَ كَلٌّ عَلَىٰ مَوْلَاهُ أَيْنَمَا يُوَجِّههُ لَا يَأْتِ بِخَيْرٍ ۗ هَلْ يَسْتَوِي هُوَ وَمَنْ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ ۗ وَهُوَ عَلَىٰ صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ)

“Allahu sjell si shembull një skllav që është në pronësi të dikujt e nuk ka në dorë asgjë dhe një njeri tjetër, të cilit Ne i kemi dhënë plot begati dhe ai jep fshehtas dhe haptas nga ato që i kemi dhënë. A janë të barabartë këta të dy?! Të gjitha lavdërimet i takojnë vetëm Allahut, por shumica

e tyre (*njerëzve*) nuk e dinë. Gjithashtu, Allahu sjell shembull edhe dy njerëz. Njëri prej atyre të dyve është memec, që nuk ka aftësi për asgjë. Ai është barrë për kujdestarin e tij e ngado që ta orientojë, ai nuk sjell ndonjë dobi. A është i barabartë ky me atë që udhëzon për drejtësi dhe ndjek rrugën e drejtë?!” (En-Nahl: 75-76)

Nëse dëshironi të njihni konceptin *el uelau ue el berau* – miqësia dhe distancimi, atëhere merreni në konsideratë shembullin e robit dhe zotëriut të tij. Një rob që miqësohet me armiqtë e zotëriut, i cili i ka dhuruar gjithë të mirat dhe përkujdeset për të, çfarë vendi zë ai te zotëriu i tij?!

Për të kuptuar vlerën e dhikrit, merrni në konsideratë shembullin e robit dhe zotëriut të tij. Një rob që nuk rresht së përmenduri vlerat e zotëriut, e lavdëron atë gjithmonë dhe ia atribuon të gjitha mirësitë atij, çfarë dashurie ka ky rob për zotëriun e tij?! Po zotëriu sa e do këtë rob?!

Për të kuptuar krimin e madh të robit të pabindur, merrni në konsideratë shembullin e robit dhe zotëriut të tij. Një rob që refuzon me kokëfortësi e arrogancë rregullat e vendimet e zotëriut të tij, dhe i zëvendëson ato me rregullat e vendimet e armiqve të tij (të zotëriut), çfarë zemërimi i ka shkaktuar zotërisë?! Si meriton të dënohet ai?!

Nuk kemi për qëllim përngjasimin në çdo drejtim, por, thjesht ky ishte një shembull për të përafruar kuptimin. Sigurisht që Allahut i takon përshekrimi më i lartë; nuk ka të ngjashëm me Të.

Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin dhe mbi familjen dhe shokët e tij!

Duke pasur një koncept të drejtë për adhurimin, ti ke mundësi që e gjithë jeta jote të shndërrohet në adhurim. Trupi dhe zemra e adhurojnë Allahun, secili në mënyrën e vet: trupi nëpërmjet sexhdes, duke e vendosur ballin në tokë e duke u ngritur prej saj në mënyrë të herëpashershme, teksa “sexhdja” e zemrës është e përhershme.

Të konceptuarit e drejtë të “ubudijetes - të qenit rob i Allahut” e bën besimtarin të shijojë adhurime të njëpasnjëshme, jo vetëm në xhami, por edhe në shtëpi, në punë, në familje e kudo. Ky është një ndër kuptimet e ajetit kuranor, në të cilin Allahu i Lartësuar thotë: **“Pasi të kesh përfunduar (preokupimet), atëhere, për hir të Zotit tënd, përpiqu fort (me adhurime)!”** (El Inshirah: 8) Në këtë kontekst, natyrshëm parashtrohen pyetjet e mëposhtme: Cila ishte ajo gjë e veçantë në zemrën e Ebu Bekrit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) që e bëri atë më të mirin e shokëve të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)? Si mund të ngjyroset gjithë jeta e besimtarit me adhurim? Si ta adhurojë besimtari Allahun jashtë xhamisë, sikurse e adhuron në xhami? Si mund jesh një adhurues i përkushtuar gjatë gjithë jetës tënde? Si mund të keni një zemër të përulur e nënshtruar ndaj Allahut? Çfarë do të thotë rebelim kundër adhurimit të Allahut dhe cilat janë format e shfaqjes së tij në realitetin bashkëkohor?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe shumë të tjerave si këto, i gjeni në këtë libër të titulluar **“Koncepti i adhurimit në Islam”**. Falënderoj Allahun e Gjithëfuqishëm, i Cili ma lehtësoi trajtimin e kësaj teme në formatin e një programi mësimor, që është i përshtatshëm për kurset e mësimimit të fesë, për qendrat islame etj.

Autori

Dr. Akil bin Salim esh-Shemri